





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.07.2020

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet në fushat e shëndetësisë dhe mirqëies sociale:organizatave jo-qeveritare,

- **Promovimi dhe përkrahëja e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes sociale të familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale .**
- **Lehtësimin e gjendjes së kategorive të personave me nevoja te veqanta :**
- **Ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e kategorive të personave në nevoj të cilet janë të organizuar në shoqata të ndryshme:**

2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo-Qeveritare si vijon:

2.1 Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushën e Mjetet financiare për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e entiteteve jopublike dhe individëve që promovojnë avancimin, fuqizimin dhe masovizimin e shëndetësisë dhe mirqëies sociale;

2.2 Vlera totale e planifikuar për këtë thirrje publike është në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej **15,000.00€**, nga fondi burimor 21 dhe 22, kodi ekonomik 21/612/73011/21200/00000/0760, në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale .

2.3 Shuma minimale e mbështetjes financiare është **500,00 €**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **2000.00 €**;

3. Mjetet financiare të planifikuara në pikën 2, paragrafi 2.3 do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekt-propozimeve të Organizatave Jo-qeveritare sipas dokumentacionit valid për zbatimin e thirrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.

4. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është pesëmbëdhjetë ditë pune dhe fillon në ditën e thirrjes publike.

5. Organizata Jo-qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një ditë dhe maksimumi një vit .
6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim.
7. Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në adresën e komunës rruga ‘Tahir Zemaj’ në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës dhe online në adresën: hysen.shamniku@arks-gov.net. Çështjet që lidhen me turrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën e cekur më lartë.
8. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë Komisioni Vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit një të vendimit.
9. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të Organizatave Jo-qeveritare.
10. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesin e suksesshëm që mund të përkrahet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, udhëheqësi mbështetur ne rekomanimit e Komisionit Vlerësues merrë vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekteve, propozimve dhe programeve të Organizatave Jo-qeveritare siq janë të profilizuara në nenin 1 të këtij vendimi.
11. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirqeine Sociale e Komunës së Fushë-Kosovës.
12. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1 x Kryetarit të Komunës
- 1 x Drejtorisë së FB
- 1 x Drejtorisë së SHMS
- 1 x Arkivit



Kryetari i Komunës
Burim Berisha